

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Mbledhja datë 22.06.2022

Agjenda e Takimit

- Fjala hapëse - **Znj. Denada Seferi, Zv. Ministër**
- 1. Prezantimi i procesit të zgjedhjes së Anëtarëve të Rinj nga Shoqëria Civile në KKShC;
- 2. Monitorimi i Udhërrëfyesit – **Znj. Elona AJAZI, Drejtor**
- 3. Prezantimi i Mekanizmave për Qeverisje të Hapur – **Znj. Oriana ARAPI, Drejtor**
- 4. Prezantimi i Ligjit "Mbi Grupet Vendore të Veprimit" – **Z. Enio CIVICI, Zv.Ministër**
- 5. Diskutime;

PIKA 2. UDHËRRËFYESI PËR POLITIKËN E QEVERISË PËR KRIJIMIN E NJË MJEDISI MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE.

Udhërrëfyesi

Udhërrëfyesi 2019-2023 përfshin tre drejtime strategjike dhe nëntë fusha prioritare, të cilat marrin në konsideratë parimet dhe objektivat e përcaktuara në udhëzimet për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile.

QËLLIMET

1. Krijimi i instrumentave dhe infrastrukturës institucionale për një dialog dhe bashkëpunim të institucionalizuar Qeveri – Shoqëri Civile.
2. Krijimin e një kuadri ligjor, institucional dhe administrativ të favorshëm për një demokraci pjesëmarrëse, si dhe për zhvillimin dhe funksionimin e sektorit të SHC.
3. Përmirësimin e financimit publik dhe regjimit fiskal të SHC.
4. Përfshirjen e shoqërisë civile në politikbërje, zbatim dhe monitorim të politikave qeveritare.
5. Përmirësimin e standarteve të shërbimeve sociale, dhe zhvillimin e qytetarisë aktive dhe vullnetarizmit.

Struktura e Udhërrëfyesit & Plani i Veprimit

Udhërrëfyeni dhe Plani i Veprimit parashikojnë masat/aktivitetet për çdo drejtim strategjik si dhe kostot respektive të planifikuara:

- **Drejtimi strategjik 1: Institucionalizimi i bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile, për bashkëpunim në hartimin e politikave dhe Integrimin në BE.**
5 fusha prioritare; 28 masa; 90 tregues
- **Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave**
2 fusha prioritare; 6 masa; 25 tregues
- **Drejtimi Strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm për organizatat e SHC**
2 fusha prioritare; 7 masa; 30 tregues

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunimi i institucionalizuar Qeveri-Shoqëri Civile në politikbërje dhe në Integrimin Evropian

- Ky drejtim përfshin 5 prioritete, 28 masa dhe 90 tregues. Në total **drejtimi i parë strategjik është realizuar në masën 85%**, nga të cilat:
 - 2 Prioritete, 20 masa dhe 68 tregues janë realizuar në masën 100%
 - 1 Prioritet në masën 96%
 - 1 Prioritet në masën 81%
 - 1 Prioritet në masën 50%

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunimi i institucionalizuar Qeveri-Shoqëri Civile në politikëbërje dhe në Integrimin Evropian (I)

ARRITJET:

- Realizmi i 76% të masave dhe treguesve të planifikuara në Udhërrëfyesi.
- Monitorimi dhe garantimi i angazhimit të vazhdueshëm për zbatim të grupit ndërmintor të punës, përfshirë të gjitha ministritë e linjës.
- Hartimi nga AMShC-ja i kuadrit rregullator për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së
- Përfshirja e KKShC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile
- Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së AMSHC për periudhën 2015-2021 për aritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbushjen e rolit të saj si sekretariat i KKShC-së.
- Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMShC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OShC-të lokale.

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunimi i institucionalizuar Qeveri-Shoqëri Civile në politikëbërje dhe në Integrimin Evropian (II)

ARRITJET

- Përshtatja e regjistrimit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OShC-të si një kategori më vete kontribuuesish
- Zhvillimi i metodologjisë për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike sipas parimeve të OECD/SIGMA
- Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi
- Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike
- Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunimi i institucionalizuar Qeveri-Shoqëri Civile në politikëbërje dhe në Integrimin Evropian (III)

ARRITJET

- Përfshirja e OShC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian
- Rritja e pjesëmarrjes së OShC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit
- Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile
- Mundësimi i përfshirjes efektive të OShC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian

Drejtimi Strategjik 1: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile (5 masa, 16 tregues)**
- Ky prioritet është realizuar në masën 81% për periudhën 2019-2021. Aktualisht nga 5 masa:
- **2 janë realizuar plotësisht në masë 100%.** Koncretisht është realizuar:
 - Planifikimi dhe zbatimi i duhur i Udhërrëfyesit.
 - Garantimi i angazhimit të vazhdueshëm për zbatim të grupit ndërmintor të punës, përfshirë të gjitha ministratë e linjës.
- **2 masa janë realizuar pjesërisht.** Masat, për të cilat institucionet përgjegjëse vijojnë të punojnë deri në realizimin e tyre janë:
 - Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecurisë së Udhërrëfyesit përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve - **Realizuar në masën 75%**
 - Mundësimi i identifikimit të OShC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun - **Realizuar në masën 50%**
- **1 masë nuk ka filluar ende.** Në përputhje me afatet e përcaktuara në Udhërrëfyes, masa 1.5: "Hartimi i Strategjisë Kombëtare/Udhërrëfyesit 2024-2028 për mbështetjen e OShC-ve" planifikohet të fillojë në vitin 2024

Drejtimi Strategjik 1: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të (9 masa, 31 fregues).**
- **7 masa janë realizuar plotësisht në masën 100%. Konkreisht janë realizuar masat:**
 - Hartimi nga AMShC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve
 - Përfshirja e KKShC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile
 - Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së AMShC për periudhën 2015-2021 për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbushjen e rolit të saj si sekretariat i KKShC-së.
 - Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMShC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OShC-të lokale.
 - Vazhdimi i asistencës teknike për AMShC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës
 - Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit
 - Caktimi i personave të kontaktit për OShC-të në ministrinë me rëndësi strategjike.

Drejtimi Strategjik 1: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **2 masa janë realizuar pjesërisht.** Masat për të cilat institucionet përgjegjëse vijojnë të punojnë deri në realizimin e tyre janë:
 - Garantimi i funksionimit eficient të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile në përputhje me planin e tij të punës dhe me angazhimet e qeverisë - **Realizuar në masën 85%.**
 - Garantimi i mbështetjes administrative efektive për Këshillin, përfshirë cilësinë e përgatitjes për të gjitha aktivitetet dhe sigurimi i ndjekjes siç duhet të të gjitha takimeve dhe aktiviteve të Këshillit – **Realizuar në masën 75%.**

Drejtimi Strategjik 1: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes dhe në integrimin evropian (5 masa, 14 tregues)**
- **Ky prioritet është realizuar 100%. 5 masat e realizuara plotësisht janë:**
 - Garantimi i zbatimit efikas të Ligjit për Njohimin dhe Konsultimin përmes ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe kombëtar dhe përfshirjes sistematike të OShC-ve.
 - Përfshirja e regjistrit elektronik të njohimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OShC-të si një kategori më vete kontribuuesish
 - Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimarrjes
 - Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi
 - Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike

Drejtimi Strategjik 1: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **Prioriteti 4: Garantimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në BE në përputhje me praktikën e mira të BE-së (5 masa, 11 tregues).**
- **Ky prioritet është realizuar 100%. 5 masat e realizuara plotësisht janë:**
 - Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian
 - Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian
 - Rritja e pjesëmarrjes së OShC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit
 - Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile
 - Mundësimi i përfshirjes efikase të OShC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian

Drejtimi Strategjik 1: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivelin vendor (5 masa, 18 tregues).**
- **Ky prioritet është realizuar në masën 50%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:**
 - Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmin – **Realizimi 0%**. Nuk ka filluar ende puna për realizimin e kësaj mase.
 - Përmirësimi i ligjit dhe akteve nënligjore të nevojshme për vullnetarizmin dhe zgjidhja e çështjes së sigurimeve bazuar në konceptin kombëtar – **Realizimi 67%**
 - Skema të financimit nga shteti për promovimin e punës vullnetare – **Realizimi 100%**
 - Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshësinë dhe përhapjen e aktiviteteve vullnetare – **Realizimi 63%**
 - Mbështetja e përfshirjes së grupeve specifike, si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare - **Realizimi 20%**.

Drejtimi Strategjik 2: Mjedis ligjor më mundësues & menaxhim i përshtatshëm i të dhënave

- **Ky drejtim përfshin 2 prioritete, 6 masa dhe 22 tregues.** Në total drejtimi i dytë strategjik është realizuar në masën 64%, nga të cilat:
 - 1 masë dhe 15 tregues janë realizuar në masën 100%
 - 1 Prioritet është realizuar në masën 77%
 - 1 Prioritet është realizuar në masën 51%

Drejtimi Strategjik 2: Mjedis ligjor më mundësues & menaxhim i përshtatshëm i të dhënave

ARRITJET

- Miratimi i Ligjit nr.80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"
- Thjeshtësimi i procedurave formale për regjistrimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse
- Fillimi punës për ngritjen e Regjistrisë Elektronike Kombëtare të OJF si dhe digjitalizimi i të dhënave historike të OJF (kontrata lidhur më 17.05.2022).

Drejtimi Strategjik 2: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- **Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri ligjor më mundësues për regjistrimin dhe operimin e OSHC-ve (3 masa, 14 tregues).**
- **Ky prioritet është realizuar në masën 77%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:**
 - Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OSHC-ve për futjen e një **procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në efçente për OSHC-të** dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të OSHC-ve – **Realizuar 100%**
 - Ndryshimi i Ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër **procesin e regjistrimit të OSHC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OSHC-ve** – **Realizuar 80%**
 - Miratimi i **akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OSHC-të** – **Realizuar 50%.**

Drejtimi Strategjik 2: Realizimi i prioriteteve dhe i masave për secilin prioritet

- ▶ **Prioriteti 7: Menaxhimi i të dhënave të OSHC-ve: mbledhja dhe analizimi i të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile në mënyrë të tillë që të kontribuojë në vendimmarrjen strategjike dhe në transparencën e skemave mbështetëse (3 masa, 11 tregues).**
- ▶ **Ky prioritet është realizuar në masën 51%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:**
 - **Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OShC-të me të gjitha funksionet – Realizimi 75%.**
 - **Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OShC-ve – Realizimi 50%.**
 - **Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të AMShC-së – Realizimi 27%**

Drejtimi Strategjik 3: Kuadër mundësues fiskal dhe financues

- ▶ **Ky drejtim përfshin 2 prioritete, 7 masa dhe 30 tregues. Në total drejtimi i tretë strategjik është realizuar në masën 63%, nga të cilat:**
 - ☐ 3 masa dhe 18 tregues janë realizuar në masën 100%
 - ☐ 1 Prioritet është realizuar në masën 96%
 - ☐ 1 Prioritet është realizuar në masën 30%

Drejtimi Strategjik 3: Kuadri mundësues fiskal dhe financues

ARRITJET

- **Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social**
 - Deri më sot **40 shërbime të ngritura me mbështetje financiare nga FS**. Në kuadër të PBA-së 2020-2022 lidhur me mbështetjen financiare në kuadër të Fondit Social është parashikuar respektivisht: viti 2020- 70 ml ALL; viti 2021- 200 ml ALL; 2022- 200 ml ALL.
 - Janë shqyrtuar **45 bashki në tre vjet dhe janë financuar 33 shërbime në nivel bashkie dhe 13 shërbime në nivel qarku**, me vlerë financimi në total 530 ml ALL.
- **Publikimi i informacionit për mundësitë e financimit të programeve të OShC-ve** (plane financimi dhe raporte vjetore)
 - **Ne faqen zyrtare të AMSHC-së çdo vit publikohet Raporti Përmbledhës i cili detajon financimet, fushën e shpërndarjes së fondeve dhe aktivitetet e AMSHC se.**
- **Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OShC-ve në aspektin e TVSh-së**
 - OJF-te të cilat operojnë me fonde të BE-se apo projekteve të tjera, donatorët e të cilave nuk pranojnë që me këto fonde të paguhen edhe tatime në Shqipëri: (i) **Është miratuar nga Ministri i Financave Udhezimi për rimbursimin e OJF-ve;** (ii) **Jane bere trajtime per administraten tatimore lidhur me kerkesat e OJF-ve dhe trajtimin e tyre te shpejte;** (iii) **Është planifikuar që në vitin 2023 të kalohet nga procedura e rimbursimit në procedurën e përjashtimit të TVSH-se që në blerje për OJF-te. U përcaktua 1 Janar 2023 pasi me pare duhet te funksionojë në mënyrë të plotë sistemi i Fiskalizimit.**

Drejtimi Strategjik 3: Kuadri mundësues fiskal dhe financues

- **Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri financues public për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikën e mira të BE-së (3 masa, 16 tregues).**
- **Ky prioritet është realizuar në masën 96%.** Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:
 - **Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OShC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë** bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime – **Realizuar 100%**
 - **Kryerja e procedurave të marrjes së statusit të NS dhe të procedurave të financimit të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet tre formave të mbështetjes financiare** – **Realizuar 83%**
 - **Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social** – **Realizuar 100%.**

DS3: Kuadri mundësues fiskal dhe financues

- **Prioriteti 9: Garantimi i një trajtimi mbështetës të OSHC-ve në të gjithë vendin sa i përket raportimit të tyre financiar, kontabël dhe tatimor (4 masa, 14 tregues).**
- **Ky prioritet është realizuar në masën 30%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:**
 - Heqja e detyrimit ligjor për OShC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar – **Realizimi 0%**
 - Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OShC-ve në aspektin e TVSh-së – **Realizuar 100%**
 - Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OShC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve - **Realizuar 20%**
 - Ndryshimi i Ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OShC-ve me qëllim nxitjen e filantropisë individuale – **Realizuar 0%.**

Faleminderit!